24.910

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr.24.910 Prot

VENDIM
PER REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot ne Tirane, me date 10.01.2001, une gjyqtarja e vetme e Gjykates se rrethit Tirane, ..., pasi mora ne shqyrtim kerkesen e dokumentat perkatese te shoqerise "SINTEZA co" sh.p.k., me seli ne Rruga "Asim VOKSHI", Nr.33, Tirane, te paraqitura nga ortaku i vetem Zonja Amneris KAPIDANI, e bija e Mas-harit, lindur ne Durres, me 27.09.1962, banuese ne Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit UG Nr.473826,

KONSTATOVA:

Se kerkesa e paraqitur nga i lartepermenduri, per regjistrimin e shoqerise "SINTEZA co" sh.p.k., me seli ne Rruga "Asim VOKSHI", Nr.33, Tirane, si person juridik per te ushtruar veprimtarine e saj, me nje afat mbi 10 vjet, sipas kontrates dhe statutit bashkelidhur, me objekt:

1. Tregtimin e mallrave te ndryshme, me shumice dhe pakice, si: prodhime elektrike dhe elektronike, farmaceutike, kimike, plastike; artikuj ushqimore dhe jo ushqimore, industriale, tekstile dhe konfeksione, kimike, hidrosanitare dhe materiale ndertimi; lende te para e gjysem te perpunuara; makineri e pajisje, linja teknologjike dhe pjese kembimi.
2. Shkembimi dhe shperndarja e informacionit; dhenia e konsulencave dhe asistences teknike; hapja e zyrave te informacionit per probleme te ndryshme.
3. Broker, duke synuar: nxitjen e informacionit tregtar, organizimin e sherbimit turistik, organizimin dhe dhenien e pervojes ne bujqesi e blegtori, transport e ndertim, spedicion, trajtim licencash, etj.
4. Import eksport

me kapital fillestar 100.000 leke, ne te cilet ortaku i vetem merr pjese si me poshte :

- Amneris KAPIDANI 100.000 leke ose 100%

me administrator te vetem Amneris KAPIDANI,
eshte e drejte dhe ne baze te ligjit duhet te pranohet.

PER KETO ARSYE :

Ne baze te nenit nr. 5 te ligjit numer 7524, date 19.11.1991, te ligjit nr. 7512, date 10.08.1991, te ligjit nr. 7632, date 04.11.1992 dhe te ligjit nr.7638, date 19.11.1992,

VENDOSA:

Regjistrimin e shoqerise "SINTEZA co" sh.p.k., me seli ne Rruga "Asim VOKSHI", Nr.33, Tirane, si person juridik per te ushtruar veprimtarine e saj, me nje afat mbi 10 vjet, sipas kontrates dhe statutit bashkelidhur, me objekt :

1. Tregtimin e mallrave te ndryshme, me shumice dhe pakice, si: prodhime elektrike dhe elektronike, farmaceutike, kimike, plastike; artikuj ushqimore dhe jo ushqimore, industriale, tekstile dhe konfeksione, kimike, hidrosanitare dhe materiale ndertimi; lende te para e gjysem te perpunuara; makineri e pajisje, linja teknologjike dhe pjese kembimi.
2. Shkembimi dhe shperndarja e informacionit; dhenia e konsulencave dhe asistences teknike; hapja e zyrave te informacionit per probleme te ndryshme.
3. Broker, duke synuar: nxitjen e informacionit tregtar, organizimin e sherbimit turistik, organizimin dhe dhenien e pervojes ne bujqesi e blegtori, transport e ndertim, spedicion, trajtim licencash, etj.
4. Import eksport

me kapital fillestar 100.000 leke, ne te cilet ortaku i vetem merr pjese si me poshte :

- Amneris KAPIDANI 100.000 leke ose 100%

me administrator te vetem Amneris KAPIDANI.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne shkalle te dyte.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 2490/1 ***VENDIMIT***

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 04.07.2002 unë gjygjtarja e gjykates se Shkalles se Pare Tirane Enkela Bajo pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga administratori I shoqerise „Sinteza" sh.p.k per dopozitimin prane Zyres se Rregjistrit tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te dokumentave te kesaj shoqerie,

K O N S T A T O V A:

Se me vendimin 24 910 date 10.01.2001 eshte rregjstruar person juridik shoqeria **„Sinteza" sh.p.k**
Me vendimin nr 1 date 02.07.2002 ortakut te vetem te shoqerise eshte vendosur largimi i administratores te shoqerise ,znj ***Ammeris Kapidani*** dhe emerimi ne vend te saj ***te z. Shkelqim Dino.***
Me kerkesen drejtuar Gjykates kerkuesja kerkon:

- Depozitimin e vendimit te mesiperm te ortakut te vetem te shoqerise ,prane Zyres se Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane .
- Pasqyrimin e ketij ndryshimi ne aktet e shoqerise.

Sa me siper cmoj se kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar .

PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit ligjit nr.7667 date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar„ dhe lidjit 7638 „Per shoqerite tregetare".

V E N D O S A.:

- Pranimin e kerkeses,
- Depozitimin prane Zyres se Rregjistrit tregetar te Gjykates se Shkalles se pare Tirane te vendimit nr 1 date 02.07.2002 ortakut te vetem te shoqerise „Sinteza" sh.p.k
- Te urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te gjykates Tirane te beje ndryshimet ne kolonen .....germa .....ne regjistrin tregtar persa I perket ndryshimit te administratorit te shoqerise .
- Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit

GJYQTARE

Enkela Bajo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR 2490/1 ***VENDIMIT***

PULLE TAKSE 100 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE - GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 07.07.2002 unë gjygjtarja e gjykates se Shkalles se Pare Tirane Enkela Bajo pasi shqyrtova kerkesen e paraqitur nga administratori I shoqerise „Sinteza" sh.p.k per dopozitimin prane Zyres se Rregjistrit tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te dokumentave te kesaj shoqerie,

K O N S T A T O V A:

Se me vendimin 24 910 date 10.01.2001 eshte rregjstruar person juridik shoqeria **„Sinteza" sh.p.k**
Me vendimin nr 1 date 02.07.2002 ortakut te vetem te shoqerise eshte vendosur largimi i administratores te shoqerise ,znj ***Amneris Kapidani*** dhe emerimi ne vend te saj ***te z. Shkelqim Dino.***
Me kerkesen drejtuar Gjykates kerkuesja kerkon:

- Depozitimin e vendimit te mesiperm te ortakut te vetem te shoqerise ,prane Zyres se Rregjistrit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane .
- Pasqyrimin e ketij ndryshimi ne aktet e shoqerise.

Sa me siper cmoj se kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar .

PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit ligjit nr.7667 date 28.1.1993 "Per regjistrin tregtar„ dhe lidjit 7638 „Per shoqerite tregetare".

V E N D O S A.:

- Pranimin e kerkeses,
- Depozitimin prane Zyres se Rregjistrit tregetar te Gjykates se Shkalles se pare Tirane te vendimit nr 1 date 02.07.2002 ortakut te vetem te shoqerise „Sinteza" sh.p.k
- Te urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te gjykates Tirane te beje ndryshimet ne kolonen .....germa .....ne regjistrin tregtar persa I perket ndryshimit te administratorit te shoqerise .
- Te ndahen regjistrimet nga njeri tjetri me vije te kuqe.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit

REPUBLIKA E SHQIPERISE - GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

GJYQTARE
Enkela Bajo

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 24910/1

VENDIM
I GJYQTARES SE VETME

Sot me date 22-12-2004., une, gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, Mariana Dedi, pasi mora ne shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Ortake e vetme dhe administratore e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " Sinteza CO" Amneris Kapedani dhe

KONSTATOVA:

Se me vendimin e Gjykates shkalles se pare Tirane Nr. 24910 date 10.01.2001 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare " Sinteza Co" sh.p.k ne rregjistrin tregtar si person juridik per te ushtruar veprimtarine e saj.

Me vendim te ortakut te vetem te shoqerise "Sinteza Co"sh.p.k dt 06.10.2004 eshte vendosur:

Te shtohet objekti i veprimtarise se shoqerise " Sinteza Co" sh.p.k edhe me : projektim dhe instalim rrjetesh kompjuterike dhe telekomunikacioni.

Nga shqyrtimi I materialeve rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar:

PER KETO ARSYE :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar"

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses.

Depozitimin ne regjistrin tregetar te vendimit te dates 06.10.2004 te ortakut te vetem te shoqerise " SintezaCo" sh.p.k

Te behen shenimet perkatese ne regjistrin tregetar.

GJYQTARE

MARIANA DEDI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr. 24910/6 Vendimi

VENDIM
I GJYQTARIT TË VETEM

Ne Tirane, sot ,me date 13 Mars 2005, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, Blerina Muça, mora ne shqyrtim kerkesen dhe aktet e paraqitura nga kerkuesi Shkelqim Dino, administrator i shoqerise " SINTEZA & CO " SHPK

KONSTATOVA

Se shoqeria " SINTEZA & CO " shpk, eshte njohur dhe regjistruar si person juridik me vendimin nr. 24910 date 10.01.2001, të Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me kapital 22.403.595 leke.
Sipas dokumentacionit te depozituar prane zyres se regjistrit tregtar ortake te shoqerise jane :
Shkelqim Dino, zoterues I 50 % te kapitalit te shoqerise dhe
Amneris Kapidani, zoterues I 50 % te kapitalit. Administrator I shoqerise eshte z. Shkelqim Dino.
Me vendimin nr. 1 date 20.02.2006 të Asamblese se Ortakeve te shoqerise "SINTEZA & CO " shpk eshte vendosur :
Transferimi i 50 % të kapitalit te zoteruar nga ortakja Amneris Kapidani, nepermjet kontrates se shitjes se kuotave nr. 516 rep dhe nr. 81 kol date 20.02.2006, ortakut Shkelqim Dino .
Pas nenshkrimit te vendimit nr. 1 date 20.02.2006 të Asamblese se Ortakeve të shoqerise dhe kontrates se shitjes se kuotave, nr. 516 rep dhe nr. 81 kol date 20.02.2006, ortak I vetem dhe administrator i shoqerise "SINTEZA & CO " shpk eshte z. Shkelqim Dino, zoterues i 100 % të kapitalit me vlere 22.403.595 leke.
Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje të ligjit 7667 date 28.01.1993 dhe ligjit 7638 date 19.11.1992

V E N D O S A

Depozitimin e vendimit nr. 1 date 20.02.2006 të Asamblese se Ortakeve te shoqerise " SINTEZA & CO " shpk sipas te cilit eshte vendosur :
Transferimi i 50 % të kapitalit te zoteruar nga ortakja Amneris Kapidani, nepermjet kontrates se shitjes se kuotave nr. 516 rep dhe nr. 81 kol date 20.02.2006, ortakut Shkelqim Dino .
Pas nenshkrimit te vendimit nr. 1 date 20.02.2006 Asamblese se Ortakeve të shoqerise dhe kontrates se shitjes se kuotave, nr. 516 rep dhe nr. 81 kol date 20.02.2006, ortak I vetem dhe administrator i shoqerise " SINTEZA & CO " shpk eshte z. Shkelqim Dino, zoterues i 100 % të kapitalit me vlere 22.403.595 leke.
Urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar të beje ndryshimet ne kollonat perkatese duke i ndare regjistrimet nga njeri tjetri me vije të kuqe.

GJYQTARE
Blerina MUÇA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
TIRANE
Nr: 24910/2

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 17/3/2001, une Gjyqtare e Gjykates se Shkalles Pare Tirane _____, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga administratori i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "Sinteza CO ", Shkelqim Dino dhe

KONSTATOVA

Me vendim te Gjyqtares vetme Nr. 24910 date 10.01.2001 te Gjykates Shkalles Pare Tirane eshte bere rregjistrimi shpk "Sinteza Co " ne rregjistrin Tregtare te Gjykates

Gabimisht emertimi i shoqerise ne kete vendim , eshte bere "Sinteza" sh.p.k duke u ometuar "co"pas flales SINTEZA, prandaj cmohet se kerkesa eshte e drejte dhe duhet pranuar, duke u ndrequr emertimi "SINTEZA co" sh.p.k.

PER KETO ARSYE

Ne baze te nenit 312 te K.Pr. Civile

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.
Ndreqjen e gabimit ne vendimin Nr. 24918/1 date 7.07.2002 te Gjyqtarit te vetem Gjykates Rrethit Tirane duke u emeruar shoqeria "SINTEZA co" sh.p.k .
Bashkimin e ketij vendimi me vendimin e meparshem.
Kunder ketij vendimi mund te behet ankim I vecante ne Gjykaten e Apelit.

GJYQTAR

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE
TIRANE

Nr. 24810/3 I VENDIMIT.

PULLE TAKSE 100 LEKE

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 20/5/2005, une Gjyqtare e Gjykates se Shkalles Pare Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga administratori i Shoqerise me Perfjegjesi te Kufizuar "Sinteza CO ", Shkelqim Dino dhe

K O N S T A T O V A

Me vendimin Nr. 24910 date 10.01.2001, te Gjyqtarit te Vetem te Gjykates Shkalles Pare Tirane, eshte vendosur :

-Rregjistrimi I shoqerise "Sinteza Co " sh.p.k me seli Rruga Asim Vokshi" Nr.33 Tirane, si person juridik per te ushtruar veprimtarine e saj me nje afat mbi 10 vjet me ortake te vetme dhe administratore Znj. Amneris Kapidani.

-Me vendim Nr. 24910/1 date 07.07.2002 te Gjyqtarit te Vetem te Gjykates Shkalles se pare Tirane eshte vendosur :

-Largimi i administratores se shoqerise Znj. Amneris Kapidani dhe emerimi ne vend te saj i Z. Shkelqim Dino.

Gabimisht emertimi I shoqerise me kete vendim eshte bere Shpk " Sinteza " duke u ometuar fjala "co" pas fjales Sinteza .

- Me vendim Nr.24910/1 date 22.12.2004, te Gjyqtarit te Vetem te Gjykates Shkalles Pare Tirane, eshte vendosur te shtohet objekti I veprimtarise i " Sinteza Co" shpk. dhe

- Me vendim Nr.24910 /2 date 17.03.2005 ,te Gjyqtarit te Vetem te Gjykates Shkalles Pare Tirane, eshte vendosur ndreqja e gabimit ne emertimin e shpk-se duke u saktesuar "Sinteza co ".

Me vendim te Asamblese se Jashtezakonshme date 11.04.2005 eshte vendosur qe te pranohet ortake i shpk "Sinteza co " edhe Zoti Shkelqim DINO , me kapital te barabarte me Znj. Amneris Kapidani me nga 50% sejcili .

Kalimi I pjeses se kapitalit eshte realizuar mbi bazen e kontrates se dhurimit Nr. 2175 rep dhe 281 kol. date 06.05.2005.

Administrator I shpk " Sinteza Co " eshte emeruar Z. Shkelqim DINO .

Sa me siper emoj se kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit Nr.7667 date 28.1.1993 " Per rregjistrin tregtar" dhe ligjit 7638 "Per shoqerite tregtare " dhe statutit te shpk "SINTEZA co"

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.
-Depozitimin prane Zyres se Rregjistrit Tregtare te Gjykates se Shkalles se pare Tirane te vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme date 11.4.2005 te shpk "Sinteza co" , ku eshte vendosur :
-Pranimi ne shoqeri i Z.Shkelqim Dino , si ortak dhe emerimi I tij administrator i shpk " Sinteza co"
-Dhurimi I 50% te kapitalit te shoqerise Z.Shkelqim Dino.
-Depozitimi I Kontrates se dhurimit Nr.2175 rep.dhe 281 kol date 06.05.2005 per kalimin e 50 % te kapitalit te shoqerise ne favor te ortakut Shkelqim Dino duke u paraqitur tani e tutje shoqeria shpk "Sinteza Co" me ortake

-Shkelqim Dino , me kapital 50%
-Amneris Kapidani , me kapital 50%
- Administrator I shpk "Sinteza co" te jete Z.Shkelqim DINO.

Urdherohet Zyra e Rregjistrit Tregtar te beje ndryshimet perkatese .
Kunder ketij vendimi lejohet ankim.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES
TIRANE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

Nr 24910/4 Vendimi

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 20.06. 2005, une gjyqtarja M. Seli ne Gjykaten e Shkalles se Pare Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Shoqeria "SINTEZA co" Shpk, perfaqesuar nga Administratori Ligjor i saj Z.Shkelqim DINO i cili kerkoi depozimin e Vendimit Nr. 1, date 02.06.2005 te Ortakeve te Shoqerise per fillimin e proçedures se rritjes se kapitalit themeltar si kontribute në natyrë te kesaj shoqerie. Pasi shqyrtova kerkesen e tij dhe u njoha me aktet perkatese,

KONSTATOVA:

Ne mbeshtetje te dispozitave te Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993, "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare", Shoqeria "SINTEZA co" Sh.p.k, eshte rregjistruar si person juridik, me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane me Nr. 24910, date 10.01.2001 me Seli ne adresen : Rruga "Asim Vokshi " Nr. 33 ,Tiranë. Me vendimin Nr. 24910/3 date 20.5 .2005 , shoqeria paraqitet me dy Ortake dhe Administrator Ligjor te saj, Z Shkelqim DINO . Shoqeria ka nje kapital te saj në vlerën prej 22.403.595 (njezetedymiljon e katerqindetremije e peseqindenetedhjeteepese) Leke.

Me Vendimin Nr. 1, date 02.06. 2005, te Ortakeve te Shoqerise eshte vendosur :

1. Fillimin e Proçedurës për rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise si kontribute në natyrë, të Shoqërisë "SINTEZA co" Shpk, si rikapitalizim i fitimit të akumuluar në vitet, nga ana e shoqërisë.

2. Kryerjen e aktit të ekspertimit, i cili do të evidentojë rritjen e mësipërme të kapitalit themeltar të shoqërisë, dhe caktimin e Zj. Tatjana Filto (Kotepano), Eksperte Kontabël e Autorizuar, me Nr. 067, për kryerjen e tij.

3. Të paraqesë këtë pranë Zyrës së Regjistrit Tregtar, pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, për t'u pasqyruar ndryshimet përkatëse në Statut dhe në kolonën e regjistrit tregtar.

Kerkohet, nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane te beje depozitimin e Vendimit Nr.1, date 02.06.2005 te dy Ortakeve te Shoqerise "SINTEZA co" Sh.p.k, ne Zyren e Regjistrit Tregtar per fillimin e proçedures per rritjen e Kapitalit themeltar te shoqerise me kontribute ne natyre dhe caktimin e ekspertit.

Pasi shqyrtova kerkesen e tij çmova se ajo eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj.

PER KETO ARSYE ;

dhe ne baze te ligjit 7638 date 19.11. 1992 "Per shoqerite tregetare", si dhe te ligjit 7 667 date 28.1.1993 "Per rregjistrin tregetar"

VENDOSA:

1. Pranimin e Kerkeses.

2. Depozitimin e Vendimit Nr. 1, date 02.06.2005, te Ortakeve te Shoqerise "SINTEZA co" Sh.p.k, ne Zyren e Regjistrit Tregtar.

3. Fillimin e Proçedurës për rritjen e kapitalit themeltar te shoqerise si kontribute në natyrë, të Shoqërisë "SINTEZA co" Shpk, si rikapitalizim i fitimit të akumuluar në vitet, nga ana e shoqërisë.

4. Kryerjen e aktit të ekspertimit, i cili do të evidentojë rritjen e kapitalit themeltar të Shoqërisë "SINTEZA co" Shpk, dhe caktimin e Zj. Tatjana Filto (Kotepano) Eksperte Kontabël e Autorizuar, me Nr. 067, për kryerjen e Aktit te Ekspertimit .

5. Te behen shenimet perkatese prane Regjistrit Tregtar.

6. Ndaj Vendimit Lejohet ankim sipas ligji.

Tirane me 20/ 06/ 2005

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË

Nr ..... Vendimi
24910/5

V E N D I M

I GJYQTARIT TË VETËM

Sot më datë 15.09.2005, unë gjyqtarja _____ në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Shoqëria "SINTEZA co" Shpk, përfaqësuar nga Administratori Ligjor i saj Z. Shkelqim Dino, i cili kërkoi depozimin e Vendimit Nr. Date 23.06. 2005, të Ortakeve të Shoqërisë për miratimin Aktit të Ekspertizës për rritjen e kapitalit themeltar të shoqërisë si kontribute në natyrë të kësaj shoqërie. Pasi shqyrtova kërkesën e tij dhe u njoha me aktet përkatëse,

K O N S T A T O V A :

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare", Shoqëria "SINTEZA co." Sh.p.k, është rregjistruar si person juridik, me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë me Nr. 24910 , datë 10.01.2001 , me Seli në adresën : Rruga "Asim Vokshi " Tiranë. Me vendim Nr.24910/3 Date 20.05.2005 te Gjykates shkalles Pare Tirane shoqeria paraqitet me dy Ortake dhe Administrator Ligjor të saj, Z Shkelqim DINO, dhe ka një kapital të saj në vlerën prej 22.403.595 (njezetedymiljonekaterqindetremije e peseqindenetedhjetepese) leke.

Me Vendimin Nr.2 , date 23.06.2005 të Ortakeve të Shoqërisë është vendosur :

1. Miratimi i Aktit të Ekspertizës të kryer nga Zj. Tatjana Filto (Kotepano), Eksperte Kontabël e Autorizuar, me Nr. 067, Liçense, e ngarkuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin Nr. 24910/4 date 20.6.2005 për kryerjen e aktit të ekspertizës për rritjen e kapitalit të Shoqërisë "SINTEZA co" Shpk.

2. Rritjen e kapitalit themeltar, si kontribute në natyrë, të Shoqërisë "SINTEZA co" Shpk, në shumën prej 22.403.595 (njezetedymiljonekaterqindetremije e peseqindenetedhjetepese) Lekë, si rikapitalizim i fitimit të akumuluar në vite, nga ana e shoqërisë.

3. Të paraqesë këtë pranë Zyrës së Regjistrit Tregtar, pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, ky vendim për t'u pasqyruar ndryshimet përkatëse në Statut dhe në kolonën e regjistrit tregtar.

Pasi shqyrtova kërkesën e tij, çmova se ajo është e drejtë dhe e bazuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE ;

dhe në bazë të ligjit 7638 datë 19.11. 1992 "Për shoqëritë tregëtare", si dhe të ligjit Nr. 7667, datë 28.1.1993 "Për rregjistrin tregëtar"

VENDOSA:

1. Pranimin e Kërkesës.

2. Depozitimin e Vendimit Nr.2 , date 23.06. 2005, të Ortakeve të Shoqërisë "SINTEZA co" Sh.p.k.

3. Miratimin e Aktit të Ekspertizës të kryer nga Zj. Tatjana Filto, Eksperte Kontabël e Autorizuar, me Nr. 067, Liçense, e ngarkuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me Vendimin Nr. 24910/4 date 20.06.2005 për kryerjen e aktit të ekspertizës për rritjen e kapitalit të Shoqërisë "SINTEZA" Shpk.

4. Rritja e kapitalit themeltar, si kontribute në natyrë, të Shoqërisë "SINTEZA co" Shpk, në shumën 22.403.595 (njezetedymiljonekaterqindetremije e peseqindenetedhjetepese) Lekë, si rikapitalizim i fitimit të akumuluar në vite, nga ana e shoqërisë.

5. Të paraqesë këtë pranë Zyrës së Regjistrit Tregtar, pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, ky vendim për t`u pasqyruar ndryshimet përkatëse në Statut dhe në kolonën e regjistrit tregtar.

5. Të bëhen shënimet përkatëse pranë Zyrës së Regjistrit Tregtar, duke u pasyruar ndryshimet përkatëse në Statut dhe në kolonën e regjistrit.

6. Ndaj këtij Vendimit Lejohet ankim sipas ligji.

Tiranë më 15 / 09 / 2005

GJ YQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
RREGJISTRI TREGTAR

URDHER RREGJISTRIMI

Kolona I	Numer i Rregjistrit tregtar 24910
Kolona II	A.Emri i Shoqerise Sinteza – co SHPK B. Selia Rr. Asim Vokshi / Nr 33 Tirana C.Objekti Tregtia me shumicë e me pakicë e produkteve informatike dhënia me koshtesë, ambulante etj D.Kapitali 100.000 leke
Kolona III	A.Ortaket Armenis Dimo e bija e Mashkurit dhe Ilirit, Tirana B.Administratoret: ortakë vetëm
Kolona IV	Kohezgjatja ubi' 10 vjet
Kolona V	Shenime mbi aktet e shoqerise A.Data e nenshkrimit 29.12.2000 B.Data e rregjistrimit 10.1.2001 C.Statuti flete 3 flete D.Akti i Themelimit flete 2 flete

Shenime: Mandat sekretim Banka Tirana
Nr 01P 3122 dt 29.12.2000

GJYQTARE

AKT THEMELUES I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"SINTEZA co" sh.p.k.

Ky akt themelues, hartohet ne Tirane, sot me date 26.12.2000, nga ortaku i vetem Zonja Amneris KAPIDANI, e bija e Mas-harit, lindur ne Durres, me 27.09.1962, banuese ne TIRANE, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit UG Nr.473826

Zonja Amneris KAPIDANI, ne baze te ligjeve te Kuvendit te Republikes se Shqiperise Nr.7512, date 10.08.991, Nr.7632, date 04.11.1992, Nr. 7638, date 19.12.1992 dhe Nr. 7764, date 02.11.1993, vendosi te ushtroje veprimtari private, duke organizuar si me poshte:

NENI 1

Te themeloje nje shoqeri tregtare per te zhvilluar veprimtarine private te emertuar:

"SINTEZA CO" sh.p.k.

Shoqeria do ta kete seline e saj ne Republiken e Shqiperise, ne Rruga "Asim VOKSHI", Nr.33, Tirane.

NENI 2

Ne perputhje me legjislacionin shqipetar shoqeria eshte person juridik. Veprimtaria e saj do te rregullohet sipas dispozitave te ketij akti themelues, te statutit te saj dhe te ligjeve shqiptare si ne fushen ekonomiko financiare ashtu dhe ne fushen profesionale. Statuti i shoqerise i bashkengjitet ketij akti themelues dhe eshte pjese perberese e tij.

Shoqeria pergjigjet vetem me pasurite e saj dhe ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e ortakut ose detyrime te tjera jashte saj.

Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e shtetit shqiptar dhe anasjelltas.

NENI 3

O B J E K T I

Objekti i veprimtarise "SINTEZA co" sh.p.k. do te jete :

1. Tregtimin e mallrave te ndryshme, me shumice dhe pakice, si: prodhime elektrike dhe elektronike, farmaceutike, kimike, plastike; artikuj ushqimore dhe jo ushqimore, industriale, tekstile dhe konfeksione, kimike, hidrosanitare dhe materiale ndertimi; lende te para e gjysem te perpunuara; makineri e pajisje, linja teknologjike dhe pjese kembimi.
2. Shkembimi dhe shperndarja e informacionit; dhenia e konsulencave dhe asistences teknike; hapja e zyrave te informacionit per probleme te ndryshme.
3. Broker, duke synuar: nxitjen e informacionit tregtar, organizimin e sherbimit turistik, organizimin dhe dhenien e pervojes ne bujqesi e blegtori, transport e ndertim, spedicion, trajtim licencash, etj.
4. Import eksport

NENI 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise caktohet mbi 10 (dhjete) vjet, kohe ko e caktuar deri me 31 dhjetor 2010, me mundesine e zgjatjes ose te shkurtimit te kelj afati para kohe me vendim te ortakut te vetem te shoqerise.

NENI 5

Kapitali themelor i shoqerise eshte 100.000 leke, i ndare si me poshte :

- Amneris KAPIDANI 100.000 leke, 100%.

Kapitali themelor do te perbehet nga mjetet e nevojshme monetare, te derdhura nga Zonja Amneris KAPIDANI, ne nje llogari rrjedhese bankare.
Kontributet e ortakut do te shenohen ne librin e llogarise, ne regjistrin e posacem te shoqerise.

NENI 6

Ortaku i vetem emeron organet drejtuese te shoqerise. Menyra e krijimit, funksionimit dhe veprimtarite e te gjithe organeve do te caktohen ne statutin e shoqerise.

NENI 7

Shoqeria e fillon veprimtarine e saj diten e regjistrimit ne Gjykaten e shkalles se pare ne Tirane dhe ne zyren e tatimeve te caktuara nga Ministria e financave (Zyra e tatimeve te qytetit te Tiranes).

NENI 8

Fitimi neto i shoqerise, pasi te jene hequr shumat qe u perkasin detyrimeve ligjore dhe fondit rezerve, i ndahet ortakut te vetem.

NENI 9

E gjithe veprimtaria e shoqerise dhe investimet e saj mbrohen nga shteti.

NENI 10

Per te gjithe ceshtjet qe nuk shenohen ne kete kontrate dhe ne statutin e shoqerise do te zbatohen dispoziatat e Kodit Civil dhe ne norma te tjera ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 11

Ky akt themelues u hartua ne 4 (kater) kopje dhe perbehet nga 2 (dy) faqe dhe 11 (njembedhjete) nene.

ORTAKU I VETEM
Amneris KAPIDANI

Tirane, me 29.12.2000

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 6388 Kol
Nr. 425 Rep

VERTETIM

Sot me date 29.12.2000, para meje noteres Elmira KODRA ne Tirane, u paraqit Amneris KAPIDANI, e bija e Mas-harit, lindur ne Durres, me 27.09.1962, banuese ne Tirane, me leternjoftimi UG Nr. 473826, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u njoha nga leternjoftimi i saj dhe me deklaroi, se jashte kesaj zyre ka hartuar kete akt themelues, e firmosi para meje dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE
Elmira KODRA

PULLE TAKSE
REPUBLIKA E SHQIPERISE
ELMIRA KODRA
NOTERE
TIRANE
1000 LEKE

STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"SINTEZA co" sh. p. k.

NENI 1

Shoqeria "SINTEZA co" sh.p.k. eshte krijuar mbi bazen e aktit themelues te firmosur nga Zonja Amneris KAPIDANI.
Karakteri i saj juridik sanksionohet ne baze te ligjit Nr.7636. date 01.11.1992 "Per shoqerite tregtare".
Shoqeria fiton te drejtat e PERSONIT JURIDIK me marrjen e te gjithe akteve ligjore, ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi "Per krijimin dhe funksionimin e personave juridike ne territorin e Republikes se shqiperise".
Ne baze te veprimtarise se shoqerise do te jene ligjet e Kuvendit te Republikes se Shqiperise:

- Nr.7512, date 10.08.1991, "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarise private te pavarura dhe te privatizimit",
- Nr. 7636, date 01.11.1992, "Per shoqerite tregtare".
- Ne te gjithe veprimtarine e saj ekonomike shoqeria detyrohet te punoje ne baze te legjislacionit te administrates shteterore shqiptare si dhe respektimit te zbatimit te akteve ta saja themelore si shoqeri tregtare.

NENI 2

Shoqeria "SINTEZA co" sh.p.k., do te kete si objekt te saj :

1. Tregtimin e mallrave te ndryshme, me shumice dhe pakice, si: prodhime elektrike dhe elektronike, farmaceutike, kimike, plastike; artikuj ushqimore dhe jo ushqimore, industriale, tekstile dhe konfeksione, kimike, hidrosanitare dhe materiale ndertimi; lende te para e gjysem te perpunuara; makineri e pajisje, linja teknologjike dhe pjese kembimi.
2. Shkembimi dhe shperndarja e informacionit; dhenia e konsulencave dhe asistences teknike; hapja e zyrave te informacionit per probleme te ndryshme.
3. Broker, duke synuar: nxitjen e informacionit tregtar, organizimin e sherbimit turistik, organizimin dhe dhenien e pervojes ne bujqesi e blegtori, transport e ndertim, spedicion, trajtim licencash, etj.
4. Import eksport

Parashtesat e mesiperme, qe lidhen me objektin e veprimtarise dhe kompetencat e saj do te vleresohen te pacenueshme.

NENI 3

Shoqeria "SINTEZA co" sh.p.k., do ta kete seline ne Rruga "Asim VOKSHI", Nr.33, TIRANE. Ajo mund te hape filiale dhe perfaqesi ta saja ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.

NENI 4

Kohezgjatja veprimtarise se shoqerise eshte e fiksuar mbi 10 vjet, me fillim nga data e regjistrimit te shoqerise dhe mund te zgjatet me vendim te otakut te vetem te shoqerise ose te shkurtohet nese per dy vjet te njepasnjeshem nuk ka zhvilluar aktivitet.

KAPITULLI I DYTE
KAPITALI I SHOQEISE, STRUKTURA, DEPOZITUESIT, PJESET E TIJ
NENI 5
KAPITALI I SHOQERISE DHE STRUKTURAT E TIJ.

Kapitali i shoqerise eshte prej 100.000 leke, i ndare si me poshte :

- Amneris KAPIDANI 100.000 leke, baraz me 100%

Ajo mund te shtohet ose te pakesohet ne cdo moment me vendim te ortakut te vetem te Shoqerise.

NENI 6
KONTRIBUTET

Struktura dhe vlerat e kapitalit te shoqerise, sic tregohen ne nenin 5, eshte formuar nga kontributi i ortakut te vetem te shoqerise si ne natyre dhe ne te holla.

Cdo ndryshim i kapitalit te shoqerise, qofte ne shtim ashtu edhe ne pakesim, mund te vendoset nga ortaku i vetem i shoqerise.

NENI 7
PJESET E KAPITALIT

Perqendrimi i te gjitha kuotave te kapitalit te shoqerise ne nje person te vetem fizik, ose juridik, nuk con ne prishjen e shoqerise.

KAPITULLI I TRETE
ORGANI DREJTUES, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE
NENI 8
ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organi drejtues i shoqerise eshte : Administratori Zonja Amneris KAPIDANI.

NENI 9

Shoqeria "SINTEZA co" sh.p.k. ka statutin e PERSONIT JURIDIK dhe vepron si e tille, nga dita e regjistrimit ne zyren e tatimeve dhe te taksave te qytetit te Tiranes.

NENI 10

Per punonjesit e punesuar prane saj, shoqeria "SINTEZA co" sh.p.k., merr persiper te repektoje te gjithe rregullat ne fuqi te punesimit ne Republiken e Shqiperise si dhe sigurimet shoqerore per to, ndersa te punesuarit jane te detyruar te pranojne statutin e shoqerise. Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes ne zbatim te legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

NENI 11
EKSPERTET KONTABEL

Administratori i shoqerise zgjedh ekspertet kontabel duke ju percaktuar shperblimin qe ju korrespondon. Ekspertet mbeten ne detyre per tre vjet, por edhe mund te rizgjidhen.

KAPITULLI KATERT
VITI FINANCIAR DHE NDARIA E FITIMIT

Vitet financiare fillojne me 1 Janar dhe mbarojne me 31 Dhjetor. Ne fund te cdo veprimtarie ushtrimore te shoqerise, administratori do te parashikoje konform dispozitave ligjore formimin e llogarise vjetore. Llogaria vjetore aprovohet nga ortaku i vetem i shoqerise brenda kater muajve nga data e mbylljes se vitit financiar. Administratori i shoqerise mund te kerkoje zgjatjen e afateve per arsye qe i quan mjaft te motivuara.

5% e fitimit neto te bilancit do te kaloje per rezervat ligjore, deri kur ajo te arrije 1/5 e kapitalit te shoqerise, ose ne rast se rezerva ka zbritur poshte ketij niveli dhe deri sa ky kalim te arrije kete nivel.

Fitimi mbetes do te destinohet konform vendimeve te ortakut te vetem te shoqerise.

Pagesa e dividentit do te behet brenda afatit te percaktuar nga ortaku i vetem i shoqerise prane arkes se caktuar nga vete ai.
Fitimet e pa terhequra brenda pese vjecarit nga dita e caktuar per terheqje kalojne ne favor te shoqerise.

KAPITULLI I PESTE
PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE
NENI 13

Shoqeria shkrihet me mbarimin e natyrshem te afateve qe jane percaktuar ne nenin 4 te ketij statuti pervec rastit ne te cilin vendoset zgjatja ose nuk kryhet prishja e parakoheshme, per arsye te parashikuara nga ligji.
Shoqeria nuk do te prishet ne rast vdekjeje ose kur deklarohet paaftesia e ortakut te vetem.
Shoqeria do te hyje ne procesin e likuidimit nga momenti i prishjes se saj. Per realizimin e ketij procesi ortaku i vetem i shoqerise do te percaktoje menyrat e likuidimit dhe do te zgjedhe nje ose shume likuidues duke percaktuar fuqite dhe shperblimin.
Ata do te hartojne nje raport ne te cilin do te paraqitet aktivi dhe pasivi i shoqerise, nje plan me operacionet lidhur me likuidimin dhe nje parashikim te afateve brenda te cilave mendojne te perfundojne procesin.
Ne perfundim te procesit te likuidimit ortaku i vetem i shoqerise do te vendose per vazhdimesine e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatet e perfundimit te parashikuara te procesit te vet likuidimit. Per gjithshka te parashikuar ne statutin ketu present i referohemi dispoziateve ligjore.

DISPOZITAT E FUNDIT
NENI 14

Ky statut eshte hartuar me date 29.12.2000, ne Tirane, ne kater ekzemplare origjinale ne gjuhen shqipe dhe firmoset rregullisht nga themeluesi i shoqerise "SINTEZA co" sh.p.k

ORTAKU I VETEM TE THEMELUES
Amneris KAPIDANI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 6385 Rep.
Nr. 426 Kol

VERTETIM

Sot me date 29.12.2000, para meje noteres Elmira KODRA ne Tirane, u paraqit Amneris KAPIDANI, e bija e Mas-harit, lindur ne Durres, me 27.09.1962, banuese ne Tirane, me leternjoftimi UG Nr.473826, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te ciles u njoha nga leternjoftimi i saj dhe me deklaroi, se jashte kesaj zyre ka hartuar kete statut, e firmosi para meje dhe une noterja e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE
Elmira KODRA

NOTERE TIRANE ELMIRA KODRA
PUBLIKE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

24910/5

KËRKESË

KËRKUESI : **Z. Shkelqim DINO , me datelindje 28.6.1958** lindur e banues në Tirane , madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr.486292 në cilësinë e Ortakut dhe të Adminstratorit Ligjor të Shoqërisë "SINTEZA co" SHPK.

OBJEKTI : *Depozitimin e Vendimit Nr. 2 date 23.06.2005 të Ortakeve të Shoqërisë "SINTEZA co" SHPK, në Gjykatën e Shkalles se Pare Tiranë.*

BAZA LIGJORE : Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1992, "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar" dhe Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhen Respektuar nga Shoqërite Tregtare".

D R E J T U A R : **GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË**

SEKSIONIT TREGTAR

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare", Shoqëria "SINTEZA co" Sh.p.k. është rregjistruar si person juridik, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, me Nr. 24910 datë 10.01.2001 , me Seli në adresën : Rruga "Asim Vokshi" Nr. 33 Tiranë. Me vendimin Nr.24910/3 date 20.05.2005 te Gjykates Shkalles Pare Tirane , shoqeria paraqitet me dy Ortake dhe Administrator Ligjor të saj, Z. Shkelqim Dino.

~~Shoqëria ka një kapital të saj në vlerën prej 22.403.595 (njezetedymiljonekaterqindetremije e peseqindenentedhjeteepese.).~~

Me Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me Nr. 24910/4 datë 20.06.2005, është vendosur :

- Depozitimi i Vendimit Nr. 1, date 02.06.2005 i Ortakeve te shoqerise" Për fillimin e proçedurës për rritjen e kapitalit themeltar si kontribute në natyrë, të Shoqërisë "SINTEZA co" Shpk, si rikapitalizim i fitimit të akumuluar në vite, nga ana e shoqërisë.
- Kryerjen e aktit të ekspertimit, i cili do të evidentojë rritjen e mësipërme të kapitalit themeltar të shoqërisë, dhe caktimin e Zj. Tatjana Filto (Kotepano), Eksperte Kontabël e Autorizuar, me Nr. 067, për kryerjen e tij.

Në zbatim të Vendimit Nr. 24910/4 date 20.06.2005 , te Gjykates, Ekspertja Kontabël e Autorizuar, ZjTatjana Filto (Kotepano) kreu Aktin e Ekspertimit, Për rritjen e kapitalit themeltar të shoqërisë, si kontribute në natyrë, të Shoqërisë "SINTEZA co" Shpk, si

24910/9

KERKESE

KERKUESI : **Z. SHKELQIM DINO ,** i biri i Uranit , i datëlindjes 28.06.1958, lindur në Tirane , shtetas shqiptar, banues ne Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës me Nr. 486292 , ne cilesine e Ortakut dhe te Adminstratorit Ligjor te Shoqerise "SINTEZA co " SHPK.

